

**Agron ISLAMI**

Instituti i Historisë “Ali Hadri”

Email: agron.islami@gmail.com

ORCID: <https://orcid.org/0000-0002-0148-0726>

KUD: 94(496.51)“1389/1448”(05)

**VËSHTRIM MBI EKSPANSIONET OSMANE NË KOSOVË:  
NGA BETEJA E PARË (1389) DERI NË TË DYTËN (1448)****Abstrakt:**

*Në kohën kur në fron erdhi sulltan Muradi i Parë (1362), Bizanti nuk ishte në gjendje tu kundërvihej zgjerimeve osmane në Rumeli (hapësira gjeografike e Ballkanit të sotëm). Në favor të vërsuljeve osmane drejtë perëndimit (Ballkanit) ishin edhe raportet e brishta politike mes Bizantit me hungarezët dhe ndasitë e vjetra fetare midis dy kishave, katolike dhe ortodokse, si dy rite të cilat kishin ndarë botën e Kryqit (krishterë) në dysh. Njëherësh, me vdekjen e Carit serb Stefan Dushanit më 1355, si dhe Uroshit në Betejën e Maricës (1371), u shpërbë formacioni i mbretërisë mesjetare Nemanjide, kështu duke u krijuar formacione të reja me elemente shtetërore që luftonin ndërmjet vete për dominim në mbretërinë jetëshkurtër të këtij të parit. Në kuadër të këtyre rrethanave të reja, principata shqiptare e Balshajve arriti ta zgjerojë sundimin e saj deri në Krivarekë (në komunë të Kamenicës së sotme), e cila shtrihej në trevat e Dardanisë antike. Hapësirë, e cila një dekadë më vonë do të bëhej arenë e dy betejave më të mëdha të kohës ndërmjet osmanëve dhe bashkimit (koalicionit) të sundimtarëve të këtyre anëve, si përfaqësues të Kryqit. Këto beteja të zhvilluara në të njëjtin vend (trevën e Fushë Kosovës së sotme) në burime të shekullit XV përmenden si Beteja e Parë dhe e Dytë e Kosovës. Në mungesë të burimeve të fundshekullit XIV, beteja e parë e Kosovës, e zhvilluar në qershor të vitit 1389, dallon shumë nga ajo e dyta e vitit 1448. Si rezultat i kësaj janë krijuar narrativa të ndryshme, duke u nisur nga legjendat e popullit, e deri tek glorifikimet e kronistëve osman dhe të tjerëve. Mbi këto legjenda të pabaza, historiografia sllave ka provuar të ndërtoj një identitet të rrejshëm mbi çështjen e një të ashtuquajturë “formësimi i vetëdijes kombëtare serbe”, që pashmangshëm duke dashur të përvetësojnë historinë e kësaj beteje, mohojnë prezencën e formacioneve shqiptare në këtë ngjarje. Ndryshe prej burimeve të*

*cilat dëshmojnë jo vetëm prezencën e shqiptarëve, boshnjakëve dhe pjesëtarë të etnive tjera të kësaj zone, por flasin edhe për rënien në fushë betejë të njërit nga liderët që kryesonte formacionet shqiptare, siç ishte Teodor Muza-ka. Derisa në betejën e dytë të zhvilluar ndërmjet ushtrive osmane dhe atyre hungarezë, baza burimore është më e pasur dhe si e tillë edhe trajtimi i kësaj ngjarje me rëndësi të madhe për të ardhmen e trevës së Ballkanit të sotmen, ka dhënë rezultate të besueshme. Ky punim i cili merr në konsideratë kronikat osmane, bizantine, shqiptare si dhe të arriturat e fundit të historiografisë mbi luftërat osmane për dominim në Ballkan ndërmjet viteve 1371-1448, në fokus ka shtrirjen e osmanëve në trevën e Evropës juglindore, me theks të veçantë historinë e dy betejave të Kosovës (1389 dhe 1448), si dy momente vendimtare për të ardhmen e sundimit osman në trevat shqiptare dhe Ballkanit në përgjithësi.*

**Fjalë kyçe:** Osmanët, shqiptarët, serbët, Betejat e Kosovës, Sulltan Murati, Teodor Muzaka, Lazar Hreblanoviç, Janko Huniadi, Skënderbeu.

**Abstract:**

*At the time when Sultan Murad I ascended the throne (1362), Byzantium was not in a position to resist Ottoman expansions in Rumelia (the geographical space of today's Balkans). Favoring the Ottoman advances toward the west (the Balkans) were also the fragile political relations between Byzantium and the Hungarians, as well as the long-standing religious divisions between the two churches, Catholic and Orthodox, as two rites that had split the Christian (Crusader) world in two. At the same time, with the death of the Serbian Tsar Stefan Dušan in 1355, and of Uroš at the Battle of Maritsa (1371), the structure of the medieval Nemanjić kingdom disintegrated, thus giving rise to new formations with state elements that fought among themselves for dominance within the short-lived realm of the former. Within the framework of these new circumstances, the Albanian principality of the Balšići managed to extend its rule as far as Krivareka (in today's municipality of Kamenica), which lay in the territories of ancient Dardania. This area, a decade later, would become the arena of the two greatest battles of the time between the Ottomans and the united (coalition) forces of the rulers of these lands, as representatives of the Cross. These battles, fought in the same location (the region of today's Kosovo Field), are mentioned in fifteenth-century sources as the First and Second Battles of Kosovo. In the absence of sources from the late fourteenth century,*

*the First Battle of Kosovo, fought in June 1389, differs greatly from the Second Battle of 1448. As a result, various narratives have emerged, ranging from popular legends to the glorifications of Ottoman and other chroniclers. On the basis of these unfounded legends, Slavic historiography has attempted to construct a false identity around the issue of a so-called "formation of Serbian national consciousness," which, in its effort to appropriate the history of this battle, inevitably denies the presence of Albanian formations in this event. In contrast to sources that attest not only to the presence of Albanians, Bosniaks, and members of other ethnic groups from this region, but also speak of the death on the battlefield of one of the leaders who headed the Albanian formations, such as Teodor Muzaka. Whereas in the second battle, fought between the Ottoman and Hungarian armies, the source base is richer, and as such the treatment of this event - of great importance for the future of today's Balkan region - has produced more reliable results. This paper, which takes into consideration Ottoman, Byzantine, and Albanian chronicles, as well as the latest achievements of historiography on the Ottoman wars for dominance in the Balkans between 1371 and 1448, focuses on the expansion of the Ottomans into the region of Southeastern Europe, with particular emphasis on the history of the two Battles of Kosovo (1389 and 1448) as two decisive moments for the future of Ottoman rule in the Albanian lands and the Balkans in general.*

**Keywords:** Ottomans, Albanians, Serbs, Battles of Kosovo, Sultan Murad, Teodor Muzaka, Lazar Hrebeljanović, János Hunyadi, Skanderbeg.

## Hyrje

Pas rreth 40 vitesh nga themelimi, Principata (Bejliku) osmane hyri në periudhën e një zhvillimi që mundësonte të vazhdonte luftën për zgjerim jo vetëm në gjeografinë e Anadollit, por edhe drejt perëndimit, përtej Ngushticës së Dardaneleve dhe Marmarasë. Pa dyshim, ky realitet vinte si rezultat i një ushtrie të përgatitur mirë, e cila ishte e brumosur në ideologjinë fetare për Luftën e Shenjtë (Gaza), që përbënte një faktor shumë të rëndësishëm për disiplinë ushtarake dhe gatishmërinë për t'iu përgjigjur thirrjes për luftë. Kështu, brenda një periudhe relativisht të shkurtër (rreth katër dekada më pas), forca ushtarake dhe politike e osmanëve interferonte dhe kishte rol përcaktues në zgjedhjen e vetë perandorit bizantin. Më 1347, në fron erdhi Jan Kantakuzen

(John Kantakouzenos) me mbështetjen ushtarake të Orhan Beut. Kjo ndihmë u konkretizua pasi, një vit më herët (1346), ai kishte lidhur kurorën e vajzës së tij Theodora-s, me Orhanin.<sup>1</sup>

Në betejën e dytë frontale ndërmjet Ioannisit V dhe Jan Kantakuzenit, Sulejman Pasha, me rreth 10000 ushtarë, i doli në ndihmë këtij të fundit, kundër Ioannisit, i cili mbështetej nga serbët, bullgarët dhe grekët. Në përfundim të kësaj beteje, e cila u zhvillua në vjeshtën e vitit 1352, hapësira e Rumelisë (Ballkanit) u shndërrua në një zonë ku ushtria osmane lëvizte lirshëm. Aq më shumë që Kantakuzeni, në vitin 1349, u detyrua që edhe njëherë t'i kërkonte ndihmë Orhanit për të çliruar Selanikun, i cili ishte pushtuar nga mbreti serb Stefan Dushani (1331-1355). Me këtë rast, së bashku me ndihmën e flotës bizantine, Sulejman Pasha, në krye të 20 mijë trupave ushtarake, i detyroi serbët të tërhiqeshin dhe e mori Selanikun për bizantinët.<sup>2</sup> Si shpërblim për këtë, perandori u dha osmanëve kështjellën strategjike *Tzympe* në Dardanele.<sup>3</sup> Dy vite më vonë, më 2 mars 1354, Galipoli u godit nga një temet, nga i cili u shkatërrua pothuajse i gjithë qyteti dhe banorët ikën drejt Kostantinopolisit (Kostandinopojës). Me këtë rast, osmanët e shtinë në dorë Galipolin, i cili ishte shpopulluar pas fatkeqësisë natyrore dhe brenda pesë vitesh të ardhshme qyteti u popullua me fise turke dhe ushtarë të sjellë nga Anadulli. Kështu, për një periudhë prej shtatë vitesh osmanët krijuan urën e parë lidhëse, e cila do t'ju mundësonte shtrirjen e mëtejme drejt zonave të tjera, drejt tokave të Ballkanit të sotëm.<sup>4</sup>

Megjithëse vërshimet osmane drejt perëndimit u ngadalësuan për një kohë pas vdekjes së Sulejman Pashës më 1357, pas konsolidimit të pushtetit nga ana e sulltanit të ri, Murati I (1362-1389), tokat e Bizantit në anën perëndimore të Anadollit u bënë cak i ushtrive osmane. Në mes viteve 1363-1364, ata pushtuan Adrianopolisin (Edirnen e sotme) dhe Filiben. Në vitin 1371, ata fituan në Betejën e Maricës kundër forcave të një koalicioni sundimtarësh ballkanikë, ku një pjesë e mirë e sundimtarëve humbës mbetën në fushëbetejë. Kjo bëri që, për një kohë relativisht të shkurtër, osmanët të pushtonin Qys-

<sup>1</sup> Stanford J. Shaw, *History of the Ottoman Empire and Modern Turkey, Volum I: Empire of the Rise of the and Decline of the Ottoman Empire, 1280-1808*, Cambridge Press: 1976, f. 16.

<sup>2</sup> Nicolae Jorga, *Osmanlı İmparatorluğu Tarihi*, Vëllimi I, (përktheu, Nilüfer Epeçeli), Istanbul: Yeditepe, 2005 f. 185

<sup>3</sup> S. J. Shaw, *History of the Ottoman Empire*, I, f. 34.

<sup>4</sup> Halil İnalcık, "Rumeli", *Diyanet İslam Ansiklopedisi*, c. 35, Istanbul: Türkiye Diyanet Vakfı, 2008, f. 232-232; N. Jorga, *Osmanlı İmparatorluğu*, I, f. 191.

tendilin, Shtipin, Manastirin, Prilepin, Sofjen, Ohrin dhe Nishin më 1386.<sup>5</sup> Përparimet osmane lidhen me përplasjet e princërve lokalë, pas realitetit që solli disfata e Maricës në vitin 1371.

Me rënin e Uroshit në Betejën e Maricës, në skenë doli Lazar Hrebljanoviçi, i cili në atë kohë sundonte me principatën me qendër në Kurshevc më 1373, me ndihmën e mbretit hungarez Ludovikut, ai arriti të mposhtte Nikolla Altomonoviçin dhe të shtinte në dorë edhe zonat minerare të Kosovës (Rudnikun, Janjevën, Trepçën dhe Novobërdën), të cilat i siguruan një fuqi ekonomike.<sup>6</sup> Mineralet nxirreshin nga minatorët saksonë dhe tregtoheshin në Itali përmes tregtarëve dubrovnikas, ndërkohë që pjesa tjetër e trevës së Kosovës ishte në duary e Vuk Brankoviçit.<sup>7</sup>

Në anën tjetër, osmanët, duke shfrytëzuar përplasjet ndërmjet princërve shqiptarë, hynë në aleancë me Karl Topinë kundër Gjergj Balshës II. Në këto rrethana, një ushtri osmane e drejtuar nga Hajredin Pasha, në vjeshtë të vitit 1385, hyri në qendrën e zotërimeve të Balshës II në Myzeqe, ku u zhvillua beteja në fushën e Savrës. Ajo përfundoi me rëniën e Balshës II në fushëbetejë dhe, si rrjedhojë osmanët i drejtuan fushatat e tyre drejt Krujës dhe Shkodrës.<sup>8</sup> Vojvoda Shahin Pasha drejtonte një ushtri drejt trevave të Bosnjës. Sipas kronistit osman Mevlana Mehmed Neshri, më 1388 *tekfuri* (sundimtari) i Shkodrës, Gjergji, i cili kishte njohur vasalitetin osman pas disfatës së Balshës II në Savër, shkoi te Lala Shahin Pasha dhe e nxiti për të organizuar një fushatë drejt Bosnjës. Njëherësh, sipas këtij kronikani, Sulltani e dekoroi

<sup>5</sup> İ. Hakkı Uzunçarşılı, *Büyük Osmanlı Tarihi*, vëll. I, Ankara: Türk Tarih Kurumu yayınları, 1989, f. 163-177.

<sup>6</sup> Feridun M. Emecen - Erhan Afyoncu, *Savaşın Sultanlar-I: O* S. J. Shaw, *History of the Ottoman Empire*, I, f. 34.

Halil İnalçık, "Rumeli", *Diyanet İslam Ansiklopedisi*, c. 35, İstanbul: Türkiye Diyanet Vakfı, 2008, f. 232-232; N. Jorga, *Osmanlı İmparatorluğu*, I, f. 191.

İ. Hakkı Uzunçarşılı, *Büyük Osmanlı Tarihi*, vëll. I, Ankara: Türk smanlı padişahlarının Meydan Muharebeleri, İstanbul: Bilge, 2018, (këtu e tutje F. Emecen - E, Afyoncu, *Savaşın Sultanlar-I*, f, 141.

<sup>7</sup> Jahja Drançolli, *Raguzanët në Kosovë (prej fundit të shekullit XIII deri në vitin 1455)*, Prishtinë: Instituti i Historisë "Ali Hadri" (ribotim), 2025, f. 19.

<sup>8</sup> Pranvera Bogdani, *Balshajt: Lufta e Principatës së Balshajve dhe sundimtarëve të tjerë shqiptarë kundër Venedikut në 20 vjetët e parë të shekullit XV*, Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike Instituti i Historisë, 2018, f. 54; Feridun M. Emecen, "'Tarihte Türk-Arnaut İlişkilerine Genel Bir Bakış – Osmanlı İdaresinin Kurulma ve Gelişme Süreci'", *Osmanlı Klasik Çağında Siyaset*, [botimi 2], İstanbul: Timaş, 2011, f. 294; İ. H. Uzunçarşılı, *Büyük Osmanlı Tarihi*, I, 176-177.

*tekfurin* e Shkodrës për informacionet e vlefshme dhe e dërgoi Shahin Pashën për ekspeditë ushtarake. Pashai, me 20.000 ushtarë, u nis për në hapësirën e Bosnjës dhe në vendin e quajtur Ploshnik (sipas kronikave raguziane më 27 gusht 1388 në Bleka), u përball me forcat boshnjake, të cilat përbëheshin nga 30.000 ushtarë. Forcat e drejtuara nga mbreti i Bosnjës, Tvërtko, asgjësuan shumicën e forcave osmane, dhe Shahin Pasha arriti të tërhiqte vetëm 5.000 ushtarë, ndërsa të tjerët mbetën në fushëbetejë.<sup>9</sup>

## **Dy Betejat e Kosovës (1389 dhe 1448), momente kyçe për të ardhmen e trevës së Ballkanit**

Beteja e Parë e Kosovës karakterizohet me bashkimin më të madh të organizuar nga princër që sundonin në hapësira të Ballkanit të sotëm. Ky bashkim u arrit pas humbjeve të njëpasnjëshme të princërve ballkanas në përballjet me ushtritë osmane. Njëherësh, fitorja e boshnjakëve në Ploshnik më 1388 u dha forcë princërve lokalë dhe u pa si tregues për nevojën e bashkimit të forcave lokale kundër osmanëve, të cilët për çdo ditë e më shumë përvetësonin toka në këto anë.

Megjithëse kronikanët osmanë të shekullit XV përmendin vetëm pjesëmarrjen e forcave shqiptare dhe nuk përmendin sundimtarët shqiptarë, kronikat e proveniencave të ndryshme vënë në dukje këtë realitet. Shembull konkret është kronisti bizantin Jeraku Logothet, i cili në kronikën e tij mbi Perandorinë Osmane, nënvizon: “Kur turqit përshkuan Dakinë e Myzinë dhe mbërritën në kufijtë e Serbisë, despoti Lazar i Serbisë, bullgarët dhe sundimtarët e Shqipërisë nga Dardania, nga Misja, nga Akrokeraunet, nga Epiri dhe nga bregdeti i Adriatikut ranë dakord dhe vendosën të luftonin...”<sup>10</sup> Po ashtu, kronika e Gjon Muzakës, e vitit 1510, rrëfen për rënien në fushëbetejë të Teodor Muzakës.<sup>11</sup> Burimet kronikore osmane tregojnë se sapo u informua sulltani për koalicionin në fjalë, ai filloi të përgatisë planin operativ për

<sup>9</sup> Mevlânâ Mehmed Neşrî, *Cihânûmâ (Osmanlı Tarihi 1288-1485)*, Hazırlayan: Necdet Öztürk, İstanbul: Çamlıca, 2008, f. 109-110 (Këtu e tutje: Neşrî, *Cihânûmâ*, f. 109-110); Feridun Emecen, Erhan Afyoncu, *Savaşın Sultanları*, Völl.I, İstanbul: Bilge, 2018, f. 143.

<sup>10</sup> Cituar sipas, Pëllumb Xhufi, “Shqiptarët e Jugut në Betejën e Fushë-Kosovës”, *Beteja e Kosovës 1389 (Përmbledhje punimesh)*, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë Instituti i Historisë, f. 110; Bedri Muhadri, *Kosova në Mesjetë, shek. XI-XV*, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2021, f. 279.

<sup>11</sup> Gjon Muzaka, *Memorje*, përktheu: Dhori Qiriazi, Tiranë: Toena, 1996, f. 19.

të penguar princërit që kishin premtuar pjesëmarrje në këtë koalicion. Në kuadër të këtij plani, ai dërgoi një formacion ushtarak të udhëhequr nga Veziri i Madh, Çandarlızade Ali Pasha, për të nënshtruar princërit bullgarë dhe vllah. Megjithëse pushtoi *Pravadin*, *Shumnun* dhe, në fund, edhe kryeqytetin bullgar, *Tërnovën*, ai nuk arriti që ta kapë mbretin bullgar, i cili kishte ikur në *Nikopolis* (Nikopojë). Ali Pasha kishte në plan të merrte edhe *Varnën*, e cila ishte nën sundimin e princit të Dobruhës, *Ivanko*, por me insistimin e gjenovezëve, ai u la i lirë. Pushtimi i Nikopolisit, së bashku me Silistren nga osmanët, bëri që mbreti bullgar *Shishman* të mbetej jashtë koalicionit të Kosovës.<sup>12</sup> Ndërkohë që Ali Pasha përparonte me pushtimet e tij në trevat e Bullgarisë së sotme, sulltani me ushtrinë e përbërë nga fiset turke marshonte drejt trevave të Dardanisë, dhe gjatë rrugëtimit i bashkoheshin edhe sundimtarët lokalë të krishterë, të cilët më herët kishin pranuar suzerenitetin osman.<sup>13</sup>

Të gjitha argumentet dëftojnë se Gjergj Balsha dhe mbreti Tvërtko ishin nga hartuesit e koalicionit, por as sundimtari i Shkodrës, Gjergj Balsha, dhe as mbreti i Bosnjës, Tvërtko, nuk kishin qenë pjesëmarrës aktivë në betejën e qershorit të vitit 1389. Për rrjedhojë, ushtria e koalicionit ballkanik kryesohej nga serbët dhe boshnjakët, e pasuar nga një formacion i shqiptarëve, si dhe nga pjesëtarë të tjerë hungarezë, vllahë, çekë etj., të cilët ishin mbledhur në Fushë Kosovën e sotme. Ndërkohë, sulltani kishte arritur të mbledhte një ushtri të përbërë nga fiset turke dhe dy vasalë sllavë, Konstantin Dejanoviçin dhe Marko Kraljeviç, sundimtarë të trevave të Maqedonisë Veriore të sotme dhe Bullgarisë. Një kronikë e hershme fiorentinase njofton edhe për pjesëmarrjen e rreth 5.000 mercenarëve grekë dhe gjenovezë të krishterë në anën e ushtrisë osmane.<sup>14</sup> Kronikat osmane rrëfejnë për një numër shumë të madh të ushtrisë kundërshtarë (100.000 – 500.000) në raport me atë osmane (60.000- 200.000) bëhej për të paraqitur forcën dhe lavdinë e kësaj të fundit.<sup>15</sup> Megjithatë, nga analizat e fundit të studiuesve të historisë së luftërave, si historiani hungarez

<sup>12</sup> Yusuf Halaçoğlu, “Kosova Savaşı”, *I Kosova Zaferi'nin 600. Yıldönümü Sempozyumu Bildirileri*, 26 Nisan 1989, Ankara: TTK, 1992, f. 29-30.

<sup>13</sup> Hoca Sadeddin Efendi, *Tacü'l-tevarih*, İstanbul: Tabhane-i Amire, 1279, f. 115. (Këtu e tutje: Sadeddin Efendi, *Tacü'l-tevarih*, f. 115).

<sup>14</sup> Cituar sipas, Noel Malcolm, *Kosova, një histori e shkurtër*, [botimi i dytë], Prishtinë-Tiranë: Koha@Shtëpia e Librit, 2001, f.64

<sup>15</sup> *Fatih Devri Kaynaklarında Düstürnâme-i Enverî: Osmanlı Kısmı (1299-1466)*, Hazırlayan: Necdet Öztürk, İstanbul: Kitabevi, 2003, f. 31; *Oruç Bey tarihi*, Hazırlayan: Necdet Öztürk, İstanbul: Bilge, 2007, f. 29; Sadeddin Efendi, *Tacü'l-tevarih*, f. 115; M. M. Neşri, *Cihânümâ*, f, 116-119.

Gabor Agoston dhe ai turk Feridun M. Emecen, tregon se diferenca ndërmjet dy koalicioneve ishte rreth 20-35.000 ushtarë, përkatësisht ushtria osmane formohej nga rreth 25.000 ushtarë dhe ajo e krishterë nga rreth 30-35.000 ushtarë.

Siç është e njohur, kjo betejë, e cila zgjati vetëm disa orë, pati një kosto të madhe për koalicionin e princërve lokalë, ashtu edhe për vetë ushtrinë osmane. Një pjesë e mirë e princërve vendorë mbetën të vrarë në fushëbetejë, ndër ta edhe Theodor Muzaka, zot i Beratit dhe Myzeqesë. Ndërkohë, sulltan Murati I, menjëherë pas betejës u ther për vdekje nga Millosh Kopiliqi, nërsa më vonë u ekzekutua edhe despoti Lazar nga ana e sulltan Bejazitit, i cili e mori fronin në afërsi të fshatit Mazgit në komunën e sotme të Obiliqit.

Sukseset osmane në shpartallimin e aleancës së sundimtarëve në betejën e vitit 1389 u dhanë mundësi atyre që të nënshtrojnë edhe zotërimet e fundit bizantine në veriperëndim të Azisë së Vogël dhe, më 1392, pushtuan edhe Bullgarinë, ku morën nën kontroll rrugët që çonin drejt Danubit.<sup>16</sup> Shtrirja e hovshme e tyre shqetësoi Vllahinë dhe Hungarinë, madje edhe vetë Papatin në Romë. Kështu, qysh më 1394, Papa Bonifaci IX, iu përgjigj mbretit të Hungarisë, Sigismundit, për organizimin e një kryqëzate të re, e cila do të ndërmerrej për të shpëtuar Hungarinë dhe për të penguar pushtimin e Konstantinopojës, e cila ishte nën rrethimin e Bejazidit I. Thirrjes së Papës iu përgjigjën fisnikë nga e gjithë bota e krishterë, duke përfshirë kontingjente të mëdha nga Franca, Hungaria dhe Gjermania, si dhe nga Kalorësit e Urdhrit të Shën Gjonit.

Beteja u zhvillua më 25 shtator 1396, në jug të Danubit, në Nikopolis (Nikopojë). Edhe kësaj radhe sulltan Bejaziti I u tregua i rrufeshëm dhe arriti të shpartallonte forcat e krishtera të udhëhequra nga mbreti i Hungarisë, Sigismundi.<sup>17</sup> Osmanët hapën kështu rrugën për të marshuar drejt Hungarisë, por vërshimi i ushtrisë së Timurlenkut (Tamerlanit) në tokat e Bejazitit, në hapësirën e Anadollit, dhe disfata e thellë osmane në Betejën e Ankarasë më 1402, ku dhe vetë Sulltan Bejaziti I vdiq si rob i Timurlenkut, e shpëtuan Hungarinë nga një pushtim i mundshëm osman.

Gjatë periudhës së *interregnumit* (1402-1413), e cila u përcoll me rivalitete të ashpra ndërmjet djemve të Sulltanit (Shehazadeve) për trashëgiminë e kurorës osmane, hungarezët vepruan pothuajse pa pengesa dhe Sigismun-

<sup>16</sup> Cemil Mureshanu, *Janko Hunyadi, Mbrojtës i Krishterimit*, [përktheu Virgjil Muçi], Tiranë: "55", 2008, f. 35. (Këtu e tutje: Mureshanu, *Janko Hunyadi*, f. 35).

<sup>17</sup> Edward. S. Creasy, *History of the Ottoman Turks, From the begining of their Empire to the prezent time*, Vol. I, London: 1854. f. 55-66.

di ndoqi një politikë mbrojtëse, me përjashtim të fortifikimit të Golubacit (1428), përmes së cilit synonte që të vendoste kontroll të plotë mbi Serbinë e sotme veriore.<sup>18</sup> Megjithatë, pas zgjidhjeve të përplasjeve të brendshme ndërmjet princërve osmanë, në fron erdhi Murati II (1421-1451), i cili i drejtoi sulmet e tij në dy kahe: drejt vijës kufitare me Hungarinë, në zonat e Serbisë së sotme që ishin nën sundimin hungarez dhe nga ana tjetër marshoi drejt trevave të Vllahisë.<sup>19</sup> Murati II rrëmbeu Golubacin nga Sigismundi dhe, pas kësaj disfate të hungarezëve, u arrit një marrëveshje paqeje, e cila njohu sundimin e despotit George Brankoviç (1427-1456). Ky i fundit, për një periudhë, shërbeu si tampon ndërmjet dy fuqive.<sup>20</sup> Dukej shumë qartë se synim i Sulltanit të ri ishte marrja e Beogradit. Për këtë arsye, Sigismundi edhe kësaj here inicioi një kryqëzatë të re kundër zgjerimeve osmane, në favor të ruajtjes së tokave hungareze.

Më 1439, kur Murati II rrethoi Beogradin, i cili ishte nën sundimin e hungarezëve, përpjekjet për kryqëzatën e radhës po vazhdonin. Dështimi i Muratit për ta pushtuar Beogradin u dha forcë hungarezëve për të ndërmarrë aksione të reja kundër osmanëve, gjë që u pa si një sinjal premtues për një kryqëzatë të re. Njëherësh, kryengritja e Skënderbeut e detyroi sulltanin, në mars 1444, të kërkonte arritjen e një paqeje dhjetëvjeçare me hungarezët. Edhe pse Vladislasi synonte rifillimin e luftës me osmanët, pas mbledhjes së *Dietës*, më 24 prill 1444, ai dërgoi përfaqësuesin e tij, Stoica Gizdaviç, i shoqëruar nga kasnecët e Janko Huniadit dhe dy përfaqësues të Brankoviçit, për të nënshkruar paqen me sulltanin.<sup>21</sup>

Pas marrëveshjes me hungarezët, sulltani, bashkë me të birin (shehzaden) Alaeddinin, marshoi drejt qytetit *Ikonion* (Konya) kundër fisit turk të Karamanëve (Kahramanoğullar), të cilët, duke shfrytëzuar luftërat osmano-hungareze, kishin rrëmbyer qytetet e sunduara nga ushtritë osmane në Anadoll. Megjithatë, sundimtari i Kahramanëve, sapo mori vesh për ekspeditën e sulltanit drejt Anadollit, i boshatisi qytetet dhe u strehua në malet pranë kufirit me Sirinë.

<sup>18</sup> Martin Chasin, "The Crusade of Varna", *History of the Crusades, The Impact of the Crusades on Europe*, Vol. VI, England: Board of Regents of the University of Wisconsin System, 1989, f. 279. (këtu e tutje: M. Chasin, "The Crusade of Varna", 279).

<sup>19</sup> Feridun Emecen, "Varna Muharebesi", DIA, Vëllimi 42, Istanbul: TDV, 2012, f. 527.

<sup>20</sup> M. Chasin, "The Crusade of Varna", f. 280.

<sup>21</sup> C. Mureshanu, *Janko Hunyadi*, f. 113.

Pas rimarrjes së qyteteve, shehzadeja u rikthye në Amasja, ndërsa sulltani në Bursa.<sup>22</sup> Pikërisht në këtë kohë, pas marrjes së lajmit të kobshëm për vdekjen e trashëgimtarit të tij (Alaaddinit), në mesin e vitit 1444, sulltani u tërhoq nga fronti në favor të Mehmetit I, duke krijuar një realitet të ri brenda vetë shtetit osman, ashtu edhe te vasalët e tij. Si rrjedhojë, osmanët hoqën dorë nga tokat e pushtuara në kohën e sulltan Muratit II Georg Brankoviçi arriti të rikthente pronat që kishte pasur nën sundim me parë. Ndërsa, me ndërhyrjen e hungarezëve, edhe sundimtari i Vllahisë rifitoi pavarësinë nga osmanët. E njëjta gjë ndodhi edhe me bijtë e Kahramanëve, të cilët rimorën qytetet në Anadoll.<sup>23</sup> Njëherësh, një aleancë e krishterë, me miratimin e Papës, kishte filluar marshimin drejt sundimeve osmane në pjesën evropiane, çka çoi në rikthimin e Muratit II në fron, edhe për shkak të presionit të madh që kryeveziri dhe vezirët osmanë ushtruan mbi Sulltan Mehmetin II për të kërkuar kthimin e të atit në fronin sulltanor. Kështu, ushtria e krishterë, e cila ishte nën komandën e mbretit hungarez dhe të kapitenit Janko Huniadi, më 22 shtator 1444 thyen kufirin osman dhe marshoi drejt Rumelisë.<sup>24</sup> Sulltan Murati II, duke marshuar nga Anadoll në tokat e Rumelisë, arriti të kalojë përmes marrjes me qira të anijeve të tregtarëve xhenovezë, pasi flota e krishterë kishte bllokuar ngushticën e Dardaneleve në Galipol (Geliboğlu), dhe me shpejtësi marshoi drejt Varnës. Dy ushtritë u përballën në fushën e Varnës. Beteja përfundoi me rënien e mbretit Vladislav, ndërsa kapiteni Janko Huniadi arriti të arratiset në Vllahi.<sup>25</sup>

Popujt e krishterë nuk ishin të njoftuar për dështimin e kryqëzatës të kryesuar nga hungarezët në Varnë. Andaj, më 1445, përfaqësues të Firences i dërguan një letër Vladislavit për ta njoftuar mbi fatin e ushtarëve të tyre.<sup>26</sup> Sipas kronikës hungareze *Chronica Hungarorum*, edhe flota e Papës nuk dinte si të vepronte me forcat e veta, dhe më në fund u arrit një ujdi me Venedikun, sipas së cilës flota do të qëndronte për një kohë në Ngushticën e Kostantinopolisit. Me qëllim të vazhdimit të Luftës së Shenjtë, anijet burgundase u drejtuan më

<sup>22</sup> Mikhael Doukas, *Tarih Anadolu ve Rumeli 1326-1462*, përktheu Bilge Umar, Istanbul: Arkeoloji ve Sanat Yayınları, 2008, f. 196.

<sup>23</sup> Halil İnalçık, “Mehmet II”, *DIA*, vëllimi 28, Ankara: TDV, 2008, f. 395.

<sup>24</sup> Gabor Agoston, *Osmanlı'da Savaş ve Serhad*, përktheu Kahraman Şakul, Istanbul: Timaş, 2013, f. 45.

<sup>25</sup> *Gazavât-ı Sultân Murâd bç Mehmed Hân, İzladı ve Varna savaşı (1443-1444) Üzerinde Anonim Gazavatnâme*, Hazırlayan: Halil İnalçık, Mevlûd Oğuz, [Botimi 2], Ankara: TTK, 1989, f. 64-66.

<sup>26</sup> N. Jorga, *Osmanlı İmparatorluğu*, I, f. 394-395.

1445 drejt Detit të Zi, ku zhvillonin sulme ndaj anijeve osmane. Ndërsa Janko Huniadi, pas një qëndrimi relativisht të shkurtër në Vllahi,<sup>27</sup> kthehet në vendin e tij, ku kuptoi se vdekja e mbretit Vladislasi nuk ishte pranuar nga populli hungarez; përkundrazi, ishte krijuar opinioni se mbreti ndodhej në Poloni dhe për një kohë të shkurtër do të kthehej.

Me të dhënë lajmin për vdekjen e mbretit, Këshilli i *Dietës* zgjodhi mbretin e ri Wladislas V, i cili në atë kohë ishte vetëm 5 vjeç. Në fillim të vitit 1446, Janko Huniadi u zgjodh përfaqësues i mbretit të ri dhe menjëherë filloi të tërhiqte vëmendjen për një hakmarrje ndaj osmanëve.<sup>28</sup> Ai synonte të ribashkonte ushtritë e ndara të kryqëzatës së Varnës. Në vitin 1447, dërgoi përfaqësuesin e tij, Nikolla Laszkocin, në Romë për të kërkuar mbështetje nga Papa i ri, Nikolla V. Megjithëse nuk mori mbështetjen e dëshiruar nga Roma, raguzanët i premtuan 2.000 florinj për çdo ditë që ushtria e tij do të kalonte Danubin. Në anën tjetër, ai kërkoi ndihmë edhe nga shtetet italiane dhe Polonia. Me këtë rast, kishte arritur të siguronte tokat e tij nuk do të sulmoheshin nga habsburgët, derisa ai të gjendej në fushatën kundër osmanëve.<sup>29</sup>

Përfaqësuesi i mbretit hungarez Janko Huniadi, kishte vendosur komunikim edhe me Gjergj Kastriotin Skënderbeun, i cili kishte premtuar asistencë me trupa shqiptare në betejën e shenjtë kundër osmanëve.<sup>30</sup> Skënderbeu shihej si një aleat i fuqishëm për aleancën e re të krishterë, sidomos pas humbjeve të mëdha që komandanti shqiptar iu kishte shkaktuar ushtrive osmane të drejtuara nga i biri i Evrenozit (Evrenuzzade), Isa Beu dhe Firuz Beu në vitin 1445.<sup>31</sup> Duhet theksuar se për sulltanin ishte e pamundur që të organizohej një ekspeditë më e gjerë kundër Skënderbeut, pasi në atë kohë gjendej në luftë me fiset turke në Anadoll. Po ashtu, brenda vetë pashallarëve osmanë ishte evidente përplasja e heshtur mes vezirëve mbështetës të Mehmetit II dhe atyre që drejtoheshin nga kryeveziri Halil Pasha Çandarliu. Megjithatë, konflikti i Skënderbeut me Venedikun për qytetin e Danjës u konsiderua si moment

<sup>27</sup> F. Emecen, E. Afyoncu, *Savaşın Sultanlar*, I, 280.

<sup>28</sup> N. Jorga, *Osmanlı İmparatorluğu*, I, 395.

<sup>29</sup> C. Mureshanu, *Janko Hunyadi*, f. 176-181.

<sup>30</sup> Marin Barleti, *Historia e Skënderbeut*, përktheu Stefan I. Prifti, (Botimi i Tretë), Tiranë: Naim Frashëri, 1982, f. 148; Franz Babinger, *Mehmed the Conqueror and His Time*, Translated Ralpf Manheim, New Jersey: Princeton University Press, f. 54, Kristo Frashëri, *Skënderbeu, Jeta dhe Vepra*, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2002, f. 156.

<sup>31</sup> *Varna (1444), İkinci Kosova (1448) Meydan Muharebeleri ve II. Murat*, Ankara: Genelkurmay Basımevi, 1986, f.91.

i duhur për të nënshtruar Shqipërinë.<sup>32</sup> Kështu, në ekspeditën e udhëhequr nga vetë Sulltan Murati dhe trashëgimtari i fronit, princi Mehmet, në verën e vitit 1448, ushtritë osmane, për një kohë të shkurtër, rrëmbyen Sfetigradin (Koxhaxhikun). Por edhe kësaj here, synimet e sulltanit mbetën pezull. Në këtë kohë, erdhi lajmi për marshimin e ushtrisë së krishterë, të udhëhequr nga Janko Huniadi drejt hapësirave të administruara nga osmanët. Si rrjedhojë, sulltani u detyrua të kthehej në Sofje për të mbledhur ushtrinë dhe për t'u përgatitur për betejën e re me hungarezët. Kjo ngjarje pasqyrohet me detaje në kronikën anonime të historisë osmane (*Anonim Tevârih-i Âl-i Osman*), ku ndër të tjera thuhet: “*Sulltan Murati doli në ekspeditë në tokat e Juvanit (Gjonit) dhe Vilajetin Shqiptar, ku u pushtua kalaja Koxhaxhik (Sfetigrad A.I.) dhe u shkatërrua Vilajeti i Juvanit (Gjonit). Derisa Skënderbeu ishte larguar (nga përballja A.I.), sulltan Muratit i erdhi lajmi për bashkimin e hungarezëve, sasëve, çekëve, almanëve (Gjermanëve), latinëve, lehëve (polonez) dhe eflakëve (vlllehëve), të cilët kishin për qëllim të hynin në Kosovë përmes Beogradit dhe Korfuzit. Sulltan Murati, me të marrë këtë lajm, marshoi nga Shqipëria drejt Sofjes, me ç’rast u dërgoi njoftim ushtarëve të Anadollit dhe Rumelisë për t’u bashkuar*”.<sup>33</sup>

Sipas një letre të Huniadit, drejtuar Papës më 8 shtator 1448, vërehet se hapja e luftës së sulltanit kundër Skënderbeut e shtyu edhe vetë Huniadin të dilte jashtë planit të dakorduar me të parin e krishterimit (Papën). Ai e justifikonte këtë veprim si nevojë për ta shfrytëzuar këtë moment për t’iu kundërvënë osmanëve. Në letrën në fjalë ai shkruante: “*Do të doja shumë t’i respektoja sugjerimet tuaja, por fakti që armiku ynë shekullor (osmanët myslimanë) kanë marrë forcë nga dështimet e njëpasnjëshme të perandorive të krishtera dhe është vërsulur nga deti dhe toka ...e kemi parë të arsyeshme që t’iu rrekemi armëve dhe luftës t’i përgjigjemi me luftë*”.<sup>34</sup> Nga kjo nënkuptohet se marshimi i Huniadit kishte filluar më herët sesa ishin dakorduar me Papën dhe se sipas gjitha gjasave, ky i fundit do të krijonte kushte shumë më të favorshme për mobilizimin e botës së krishterë. Në anën tjetër, burimet raguzane, ashtu sikurse edhe kronisti osman Ashëk Pashazade, marshimin e

<sup>32</sup> K. Frashëri, *Skënderbeu, Jeta dhe Vepra*, 150.

<sup>33</sup> *Anonim Tevârih-i Âl-i Osman*, Hazırlayan: Nihat Azamat, İstanbul:Marmara Üniversitesi Fen-Edebiyat Fakültesi 1992, f. 39, për një përkthim më të zgjeruar shih, Agron Islami, “Dy Betejat e Kosovës (1389 dhe 1448) në perceptimin e kronistëve osman”, *Albanologji* 6/II, Prishtinë: Instituti Albanologjik, f. 189-196.

<sup>34</sup> F. Emecen, E. Afyoncu, *Savaşın Sultanlar*, I, 283.

hershëm të Huniadit e lidhin me rrjedhjen e informacionit mbi përgatitjet e kryqëzatës në fjalë.<sup>35</sup> Kronikani osman shkruan se ishte Gjuraq Brankoviçi ai i cili i dha lajmin sulltanit mbi përgatitjen e ushtrisë së krishterë për një betejë të re kundër osmanëve. Më tej, në të njëjtin burim thuhet se sulltani nuk kishte besim te Georg Brankoviçi dhe dërgoi Martalaz Doganin për të vërtetuar këtë informatë. Ky i fundit e konfirmoi saktësinë e informatës së Brankoviçit dhe e njoftoi sulltanin se ushtria e krishterë përbëhej nga batalione polako-lituaneze (lehë), çeke dhe gjermane, që drejtoheshin nga *banë* të shquar, ndërsa në krye të tyre ishte vetë Huniadi.<sup>36</sup>

Ushtria e krishterë, e udhëhequr nga Huniadi, si vend hakmarrjeje ndaj osmanëve kishte përzgjedhur Fushë Kosovën, vend në të cilin ishte zhvilluar edhe Beteja e Parë e Kosovës (1389), e cila edhe pse kishte përfunduar me fitoren e osmanëve, rënia e Sulltan Muratit I në Kosovë kishte lënë një shije të hidhur në kujtesën historike osmane.<sup>37</sup> Sipas kronikave osmane, para fillimit të luftimeve, Sulltan Murati II i kishte dërguar një emisar Huniadit me qëllim që të arrihej një marrëveshje paqësore, por Huniadi nuk kishte pranuar as të ulej në tryezën e bisedimeve.<sup>38</sup>

Megjithëse në Betejën e Parë të Kosovës ushtritë e krishtera kishin ardhur për ta mbrojtur Kosovën nga pushtimi osman, në këtë rast qytetet e Kosovës u shkretuan nga vetë kjo ushtri, si rezultat i qasjes së Brankoviçit, i cili nga Huniadi u konsiderua armik.<sup>39</sup> Në mëngjesin e 17 tetorit 1448, ushtria e sulltanit, e nisur nga Edirneja (Adrianopoli), arriti në zonën e Prishtinës, prej nga u drejtua drejt Fushë Kosovës. Në krye të saj gjendej bejlerbeu i ri i Rumelisë, Özgür Bej, nga familja fisnike e Zgurajve të Beratit, pastaj sanxhakbeu i Shqipërisë, Isa Beu, si dhe Hiziri dhe vëllai i Saruxha Pashës, Sinan Beu, të cilët ishin në krye të formacioneve shqiptare, serbe dhe bullgare.<sup>40</sup>

Beteja, e cila zgjati 3 ditë, filloi me 17 tetor 1448 dhe përfundoi më 19 tetor me fitoren e sulltanit. Gjenerali hungarez Janosh Huniadi edhe në këtë Betejë përdori taktikën luftarake *Wagenburg*, të cilën e kishte mësuar gjatë luftërave me husitët në Bohemi (1419-1436). Kjo taktikë ishte e njohur për

<sup>35</sup> Jahja Drançolli, Kosova Më 1448 Sipas Kronikave Dhe Historive Të moçme Të Raguzës”. *Kosova*, nr. 17, Prishtinë, f. 253.

<sup>36</sup> *Aşık Paşazade Osmanogulları'nın Tarihi*, İstanbul:Mas Kitaplığı, 2003, f. 209-212.

<sup>37</sup> E. Creasy, *History of the Ottoman Turks*, 116.

<sup>38</sup> İ. Hakki Uzunçarşılı, *Büyük Osmanlı Tarihi*, vëllimi 1, 447.

<sup>39</sup> N. Jorga, 400.

<sup>40</sup> Po aty. 402.

osmanët që nga Beteja e Varnës (1444); për pasojë ata ia dolën suksesshëm që të rrethonin karrocën e vagonëve dhe ta linin jashtë rrezes së luftimeve, duke e detyruar armikun të hiqte dorë nga pozicionet.<sup>41</sup> Ashtu si në Betejën e Varnës më 1444, edhe kësaj radhe Huniadi u detyrua të tërhiqej nga fushëbeteja si humbës.<sup>42</sup>

## Përfundime

Beteja e Parë e Kosovës e vitit 1389, e cila karakterizohet me mbledhjen e aleancës më të madhe të deriatëhershme të sundimtarëve të trevave të Ballkanit të sotëm, karshi vrullit të zgjerimeve osmane, përbën luftën vendimtare të këtyre të fundit, për të sunduar Ballkanin për shekuj me radhë (madje, osmanët në këtë kohë, akoma ishin në suaza të konsolidimit shtetëror (perandorak)). Megjithëse, deri në dekadën e kaluar, në historishkrimin nacionalist (sidomos serb) ka mbizotëruar narrativa e vdekjes në fushëbetejë të liderëve kryesorë të koalicioneve si Sulltan Murati dhe Lazari, burime dhe rrëfime të ndryshme e bëjnë këtë çështje të paqartë. Për shembull, ndërsa në kronikat katalonase përmendet rënia e Lazarit në fushëbetejë gjatë përballjes me Subashin e Ejnes, Konstantini nga Novobërda, në kronikën e tij të shkruar gjatë viteve të robërimit në Stamboll, thekson se, Lazari, së bashku me vojvodën Krajmir, u zunë rob në afërsi të kishës në Samadrexhë (në afërsi të Prizrenit, A.I.) dhe u dërguan në divanin e sulltanit të ri, Bejazitit I, ku më pas u ekzekutuan. Disfata e forcave të sundimtarëve të Ballkanit në këtë betejë disa orëshe, vulosi edhe të ardhmen e administratës osmane në hapësirat e Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë, Bosnjës dhe Serbisë, e cila u përçoll me ndryshime politike, sociale dhe ekonomike në shekujt në vazhdim. Kështu, menjëherë pas këtij realiteti të ri, Sulltan Bejaziti I (1389-1402), pasues i Muratit I, fuqizoi ndikimin osman në hapësirën e Dardanisë antike (Kosovë dhe Maqedoni Veriore e sotme), duke i vasalizuar të birin e Lazarit, Stefan Lazareviçin, si dhe djemtë e Vuk Brankoviçit (Gërgurin dhe Gjergjin), të cilëve iu njoh sundimi i pjesës më të madhe të Kosovës. Ndërsa, Evrenos Pasha, Jigit Pasha dhe Firuz Bej u

<sup>41</sup> Agoston, Gabor, *The Last Muslim Conquest: The Ottoman Empire and its war in Europe*, Princeton & Oxford: Princeton University Press, 2021, f. 71-72.

<sup>42</sup> Halil İnalcık, "The Ottoman Turks and the Crusades", *History of the Crusades, The Impact of the Crusades on Europe*, Vëllimi VI, England: Board of Regents of the University of Wisconsin System, 1989, f. 275.; Konstantin Mihail Konstantinoviç, *Yeniçeriler ve Bir Yeniçerinin Hatıratı*, Haz. Kemal Beydilli, Istanbul: Pınar Yayınları, 2019, f. 64.

dërguan në ekspedita ushtarake në drejtim të rajoneve të Maqedonisë Veriore të sotme dhe Bullgarisë. Kjo ekspeditë është pasqyruar në historinë tregimtare të kronistit osman Hadidi, i cili ndër të tjera thotë: “*Në vend të babait të tij (Muratit I) erdhi në fron Bejaziti I, (i mbiquajtur Jëlldërim/Rrufeja), ku rrëmbeu thesaret e çmueshme të minierës në Kratovë. Ndërsa, Jigit Pasha u dërgua në Shkup, kurse rrethinën e Vidinit e mori Firuz Beu*”. Kështu, Jigit Pasha, më 1392 e pushtoi Shkupin dhe e ktheu atë në qendër të rëndësishme të inkursioneve osmane në drejtim të hapësirave shqiptare.

Beteja e Dytë e Kosovës e vitit 1448, e cila prapë u iniciua nga kampi i krishterë, si hakmarrje ndaj humbjeve të njëpasnjëshme të këtyre të fundit në Nikopolis (1396) dhe Varna (1444) karshi ushtrisë së sulltanëve osmanë, po ashtu përbën momentin vendimtar të osmanëve për dominim në Ballkan, ashtu sikurse sheroi edhe elanin e hungarezëve për t’u matur me ushtritë osmane në trevat e Ballkanit të sotëm. Madje, nga këtu e tutje osmanët jo vetëm që shtrinë administratën në këto anë, por u shndërruan në sulmues kundrejt vetë Hungarisë, e cila ra në pozicion mbrojtjes. Skënderbeu, i cili nuk kishte arritur të dërgonte forcat e premtuara në këtë betejë, tashmë kishte mbetur i vetmuar përballë sulmeve të njëpasnjëshme osmane.

Ndryshe nga Beteja e Parë e Kosovës, ku formacionet shqiptare në krah të ushtrisë osmane merrnin pjesë si vasalë, në Betejën e Dytë të Kosovës, ata shfaqen në pozita udhëheqëse. Shembulli i kësaj është pinjulli i Zgurajve të Beratit, i cili në këtë betejë mbante postin e bejlerbeut të Rumelisë. Formacionet shqiptare, serbe dhe bullgare komandoheshin nga sanxhakbeu i Shqipërisë, Isa Beu, Hiziri (Hızır) dhe vëllai i Saruxha Pashës, Sinan Beu.

Nga aspekti i taktikës së luftës, Beteja e Dytë e Kosovës dallonte shumë nga Beteja e Parë e vitit 1389. Derisa në Nikopolis, Sulltan Bejaziti, arriti që të neutralizonte forcat e krishtera me taktikën e rrethimit, këta të fundit në Varna përdorën taktikën wagenburg, taktikë e cila u tentua të aplikohet edhe në Betejën e Dytë të Kosovës, por që ishte e pasuksesshme, pasi që osmanët iu kundërpërgjigjën me rrethimin e karrocave zinxhirore të cilat mbetën jashtë rrezes së luftimeve. Në këtë betejë nga palët luftuese u përdorën pushkë zjarri dhe topa të vegjël, gjë që ishte një zhvillim teknologjik për kohën.

## Bibliografi:

### Kronika dhe vëllime dokumentare:

- *Aşık Paşazade Osmanoğulları'nın Tarihi*, İstanbul:Mas Kitaplığı, 2003.
- *Âşık Paşazâde, Tevârih-i Âl-i Osman*, Hazırlayan: Kemal Yavuz, M.A. Yekta Saraç, İstanbul 2010.
- *Anonim Tevârih-i Âl-i Osman*, Hazırlayan: Nihat Azamat, İstanbul:Marmara Üniversitesi Fen-Edebiyat Fakültesi 1992.
- Doukas, Mikhael, *Tarih Anadolu ve Rumeli 1326-1462*, përktheu Bilge Umar, İstanbul: Arkeoloji ve Sanat Yayınları, 2008.
- *Gazavât-ı Sultân Murâd b. Mehemed Hân, İzladi ve Varna savaşı (1443-1444) Üzerinde Anonim Gazavatnâme*, Hazırlayan: Halil İnalçık, Mevlûd Oğuz, [Botimi 2], Ankara: TTK, 1989.
- Gjon Muzaka, *Memorje*, përktheu: Dhori Qiriazi, Tiranë: Toena, 1996.
- *Hadidi, Tevârih-Âl-i Osmân*, Haz. Necdet Öztürk, İstanbul, 1991.
- Hoca Sadeddin Efendi, *Tacü 't-tevarih*, İstanbul: Tabhane-i Amire, 1279.
- Konstantin Mihail Konstantinoviç, *Yeniçeriler ve Bir Yeniçerinin Hatıratı*, Kemal Beydilli, İstanbul: Pınar Yayınları, 2019.
- Marin Barleti, *Historia e Skënderbeut*, përktheu Stefan I. Prifti, (Bitimi i Tretë), Tiranë: Naim Frashëri, 1982.
- Mevlânâ Mehmed Neşrî, *Cihânümâ (Osmanlı Tarihi 1288-1485)*, Hazırlayan: Necdet Öztürk, İstanbul: Çamlıca,2008.
- *Oruç Bey Tarihi*, Hazırlayan: Necdet Öztürk, İstanbul: Bilge, 2007.

### Monografi & Punime shkencore:

- Agoston, Gabor, *The Last Muslim Qonquest: The Ottoman Empire and its war in Europe*, Princeton & Oxford: Princeton University Press, 2021.
- Agoston, Gabor, *Osmanlı'da Savaş ve Serhad*, përktheu: Kahraman Şakul, İstanbul: Timaş, 2013.
- Babinger, Franz, *Mehmed the Conqueror and His Time*, Translated: Ralpf Manheim, New Jersey: Princeton University Press, 1967.
- Creasy, S. Edward, *History of the Ottoman Turks, From the begining of their Empire to the prezent time*, Vol. I, London: 1854.
- Egro, Dritan, "Islam in Albanian Lands During the First Two Centuries of The Ottoman Rule" (disertacion doktrature), Ankara: *The Institute of Economics and Social Sciences of Bilken University*, 2003.

- Emecen, M. Feridun, “Varna Muharebesi”, *Dianet İslam Ansiklopedisi*, c. 42, İstanbul: Türkiye Diyanet Vakfı, İstanbul, 2012.
- Emecen, M. Feridun, “Tarihte Türk-Arnavut İlişkilerine Genel Bir Bakış – Osmanlı İdaresinin Kurulma ve Gelişme Süreci”, *Osmanlı Klasik Çağında Siyaset*, [botimi 2], İstanbul: Timaş, 2011.
- Emecen M. Feridun - Afyoncu, Erhan, *Savaşın Sultanlar-I: Osmanlı padişahlarının Meydan Muharebeleri*, İstanbul: Bilge, 2018.
- *Fatih Devri Kaynaklarında Düstûrnâme-i Enverî: Osmanlı Kısmı (1299-1466)*, Hazırlayan: Necdet Öztürk, İstanbul: Kitabevi, 2003.
- Frashëri, Kristo, *Skënderbeu, Jeta dhe Vepra*, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2002.
- Drançolli, Jahja, “Kosova Më 1448 Sipas Kronikave Dhe Historive Të moçme Të Raguzës”. *Kosova*, nr. 17, Prishtinë, 249-66.
- Drançolli, Jahja, *Raguzanët në Kosovë*, (ribotim), Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2025.
- Duka, Ferit, “Pushtimi i Kosovës”, *Kosova Vështrim Monografik*, Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2011.
- Duka, Ferit, *Shekujt Osmanë në Hapësirën Shqiptare (Studime dhe dokumente)*, Tiranë: UET Press, 2009.
- *Historia e Popullit Shqiptarë I*, Tiranë: Akademia e Shkencave të Shqipërisë – Instituti i Historisë, 2002.
- Halaçoğlu, Yusuf, “Kosova Savaşı”, *I Kosova Zaferi'nin 600. Yıldönümü Sempozyumu Bildirileri*, 26 Nisan 1989, Ankara: TTK, 1992.
- İnalçık, Halil, “Mehmet II”, *DIA*, c. 28, Ankara: TDV, 2008.
- İnalçık, Halil, “Rumeli”, *Dianet İslam Ansiklopedisi*, c. 35, İstanbul: Türkiye Diyanet Vakfı.
- Islami, Agron, *Areali i Kosovës në kohën osmane: një Histori socio-ekonomike e shekullit XVIII*, Prishtinë: Instituti I Historisë “Ali Hadri”, 2024.
- Islami, Agron, “Dy Betejat e Kosovës (1389 dhe 1448) në perceptimin e kronistëve osman”, *Albanologji* 6/II, Prishtinë: Instituti Albanologjik, f. 189-196.
- J. Shaw, Stanford, *History of the Ottoman Empire and Modern Turkey, Volum I: Empire of the Rise of the and Decline of the Ottoman Empire, 1280-1808*, Cambridge Press: 1976.
- Jorga, Nicolae, *Osmanlı İmparatorluğu Tarihi*, c. I, përktheu, Nilüfer Epçeli, İstanbul: Yeditepe, 2005.

- 
- Malltezi, Luan, *Beteja e Fushë- Kosovës dhe Shqiptarët 1389*, Tiranë: Koha [ribotim], 1999.
  - Malcolm, Noel, *Kosova, një histori e shkurtër*, [botimi i dytë], Prishtinë-Tiranë: Koha@Shtëpia e Librit, 2001.
  - Muhadri, Bedri, *Kosova në Mesjetë, shek. XI-XV*, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2021.
  - Mureshanu, Cemil, *Janko Hunyadi, Mbrojtës i Krishterimit*, [përktheu Virgjil Muçi], Tiranë: “55”, 2008.
  - Pulaha, Selami, “Shqiptarët dhe beteja e Fushë-Kosovës e vitit 1389”, *Beteja e Kosovës 1389*, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë – Instituti i Historisë, 2005.
  - Uzunçarşılı, İ. Hakkı, *Büyük Osmanlı Tarihi*, c. I, Ankara: Türk Tarih Kurumu yayınları, 1989.
  - Xhufi, Pëllumb, “Shqiptarët e Jugut në Betejën e Fushë-Kosovës”, *Beteja e Kosovës 1389 (Përmbledhje punimesh)*, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë Instituti i Historisë, 2005.

**Agron ISLAMI**

The Institute of History “Ali Hadri”

Email: agron.islami@gmail.com

ORCID: <https://orcid.org/0000-0002-0148-0726>

KUD: 94(496.51)“1389/1448”(05)

**SUMMARY****A VIEW OF OTTOMAN EXPANSION IN KOSOVO:  
FROM THE FIRST BATTLE (1389) TO THE SECOND (1448)**

The First Battle of Kosovo in 1389, characterized by the gathering of the largest alliance up to that time among the rulers of the regions of today’s Balkans in response to the momentum of Ottoman expansion, represents the decisive battle that enabled the Ottomans to rule the Balkans for centuries (indeed, at this time the Ottomans were still in the process of state – imperial – consolidation). Although, until the past decade, nationalist historiography (especially Serbian) emphasized the narrative of the death on the battlefield of the main leaders of the opposing coalitions, such as Sultan Murad and Lazar, in various narrative histories this issue remains unclear. For example, while the Catalan chronicles mention Lazar’s fall on the battlefield during his clash with Subashi of Einës, Konstantin of Novo Brdo, in his chronicle written during his years of captivity in Istanbul, states that Lazar, together with the vojvoda Krajmir, was captured near the church in Samodreža (near Prizren, A.I.) and taken to the divan of the new Sultan, Bayezid I, where they were executed. The defeat of the forces of the Balkan rulers in this several-hour battle sealed the future of Ottoman administration in the territories of Albania, Kosovo, Macedonia, Bosnia, and Serbia, which in the following centuries would be accompanied by political, social, and economic transformations. Thus, immediately after this new reality, Sultan Bayezid I (1389–1402), the successor of Murad I, strengthened Ottoman influence in the area of ancient Dardania (present-day Kosovo and North Macedonia), by turning Lazar’s son, Stefan Lazarević, as well as the sons of Vuk Branković (Gërgur and Gjergj), into vassals, granting them recognition over the rule of most of Kosovo.

Meanwhile, Evrenos Pasha, Yigit Pasha, and Firuz Bey were dispatched on military expeditions toward the regions of present-day North Macedonia and Bulgaria. This expedition is reflected in the narrative history of the Ottoman chronicler Hadidi, who, among other things, states: “*In place of his father (Murad I), Bayezid I, known as Yildırım (the Thunderbolt), ascended the throne, who seized the precious treasures of the mine in Kratovo. (Meanwhile) Yigit Pasha was sent to Skopje, while the region of Vidin was taken by Firuz Bey.*” Thus, in 1392, Yigit Pasha conquered Skopje and transformed it into an important center of Ottoman incursions toward Albanian territories. The Second Battle of Kosovo in 1448, which was again initiated by the Christian camp as retaliation for their successive defeats at Nicopolis (1396) and Varna (1444) at the hands of the Ottoman sultans’ army, likewise represents a decisive moment for the Ottomans in securing dominance in the Balkans, while also exhausting the Hungarians’ momentum to confront the Ottoman armies in the regions of today’s Balkans. Indeed, from this point onwards, the Ottomans not only extended their administration in these areas, but also turned into aggressors against Hungary itself, which fell into a position of self-defense. Skanderbeg, who had been unable to send the promised forces to this Battle, now remained alone in the face of successive Ottoman assaults.

Unlike the First Battle of Kosovo, where the Albanian formations fighting alongside the Ottoman army participated from the position of vassals, in the Second Battle of Kosovo we find them in leading positions. Such is the case with the descendant of the Zguraj family of Berat, who in this battle held the post of Beylerbey of Rumelia. Meanwhile, the Albanian, Serbian, and Bulgarian formations were commanded by the Sanjakbey of Albania, Isa Bey, by Hizir (Hızır), and by the brother of Saruxha Pasha, Sinan Bey.

From a tactical perspective, the Second Battle of Kosovo differed greatly from the first battle of 1389. While at Nicopolis Sultan Bayezid managed to neutralize the Christian forces through the tactic of encirclement, the latter employed the wagenburg tactic at Varna. This tactic was also attempted in the Second Battle of Kosovo, but it proved unsuccessful, as the Ottomans countered it by encircling the chained wagons, which remained outside the effective range of combat. In this battle, both sides used firearms and small cannons, a technological development for the period.